

**VENDIM**  
**Nr.383, datë 19.5.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË  
KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME,  
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE<sup>1</sup>**  
(*Ndryshuar me VKM nr.792, datë 6.10.2010; nr.19, datë 9.1.2013; nr.805, datë 29.12.2017;  
nr.90, datë 14.2.2018*)

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të nenit 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. *Agjencia e Trajtimit të Pronave (në vijim ATP)*, në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes së vet zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.

2. Në njoftimin publik duhet të përcaktohen:

a) gjenealitetet e përfituesit;

b) *shfuqizuar*;

c) dokumentacioni i nevojshëm shoqërues i kërkesës;

ç) vlera e tarifës së shërbimit;

d) detyrimi për subjektet përfituese për të hapur, në emër dhe për llogari të tyre, një llogari bankare në njërën nga bankat e nivelit të dytë.

3. Procesi i regjistrimit/pranimi të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.

4. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin e shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, dhe shpërndarjen e fondit përkatës.

5. Kjo procedurë kryhet për çdo fond që i kalon ATP-së sipas ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, dhe në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale. Kompensimi bëhet në masën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, ku parashikohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.

6. Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë i tij, brenda afatit të përcaktuar në njoftimin publik, paraqet pranë zyrës së ATP -së, dokumentacionin e mëposhtëm:

---

<sup>1</sup> VKM nr. 383, datë 19.5.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.75, 30 qershor 2010.  
VKM nr.792, datë 6.10.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, 7 tetor 2010.  
VKM nr.19, datë 9.1.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, 16 janar 2013  
VKM nr.805, datë 29.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.239, 8 janar 2018.  
VKM nr.90, datë 14.2.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, 19 shkurt 2018.

- a) Kërkesën për kompensimin e pronës sipas formatit tip, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie;
- c) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre;
- ç) Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;
- d) shfuqizuar;
- dh) Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

*6/1 Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, sipas shkronjës "c" të pikës 6, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Nëse kërkesa paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve, ajo shoqërohet nga prokura e posaçme e nënshkruar prej tyre, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre.*

*Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi, pavarësisht se i përket së njëjtës pasuri të paluajtshme.*

**7. ATP-ja bashkëpunon me ALUIZNI-n dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për verifikimin e konfirmimin e të dhënave për subjektet përfituese.**

*Në rast se në listat e përfituesve, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, konstatohen gjenealitete të ndryshme të subjekteve nga ato faktike të tyre, atëherë ATP-ja ka të drejtë të verifikojë dhe të provojë, bazuar në të dhënat e përgjithshme të pasurisë dhe të trashëgimisë të marra në institucionet e treta, se gjenealitetet e subjekteve përfituese janë të njëjta me ato të subjekteve të publikuara në listat e vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.*

**8. Grupi i punës, sipas pikës 4 të këtij vendimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kryen veprimet e mëposhtme:**

- a) Verifikon legjitimitimin e kërkesit për çdo kërkesë për kompensimin e pronës;
- b) Kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përfitues;
- c) Konfirmon të dhëna të tjera të nevojshme pranë institucioneve përkatëse;
- ç) Harton relacionin, në të cilin i propozon Drejtorit të Përgjithshëm kalimin e shumës në numrin e llogarisë bankare përkatëse;
- d) shfuqizuar.

**9. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës:**

- a) nxjerr vendimin për miratimin e listës së subjekteve që kompensohen, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të derdhet vlera e kompensimit;
- b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen;
- c) njofton kërkuessin, që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

*9/1 Subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë pas plotësimit të mangësive të konstatuara.*

*Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.*

**10. ATP-ja, brenda 5 ditëve nga miratimi i kërkesës dhe listës së subjekteve që kompensohen, kryen veprimet me degën e thesarit dhe bankën e nivelit të dytë për derdhjen e shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.**

*Për marrjen e kësteve në vijimësi, subjekti përfitues nuk duhet të paraqesë kërkesë të re për përfitim. ATP-ja, në varësi të kriterëve të shpërndarjes së fondit të kompensimit dhe gjendjes së tij, bën derdhjen e shumës përkatëse në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, duke e njoftuar atë për veprimin bankar të kryer.*

*11. ATP-ja realizon ndarjen e fondit të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri, të cilat preken nga ndërtimet informale, deri në të njëjtën masë të përfituar në këstin e parë nga subjektet e kompensuara më parë.*

*Pjesa e fondit, e mbetur pa u shpërndarë, si pasojë e mosaplikimit të subjekteve përkatëse, shpërndahet nga ATP-ja në vlerë proporcionale, për këstet e mbetura të subjekteve që kanë përfituar të drejtën e shpërblimit më parë në kohë. Fillimisht, nëse pjesa e mbetur e fondit është e mjaftueshme, ATP-ja procedon me shpërndarjen deri në masën e plotë të shpërblimit për subjektet, të cilëve u ka lindur e drejta e kompensimit njëkohësisht dhe më parë në kohë, krahasuar me subjektet e tjera, referuar datës së vendimit të Këshillit të Ministrave, që përcakton shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.*

*Në këtë mënyrë vijohet deri në shpërndarjen e vlerës së plotë të shpërblimit për të gjitha subjektet që e kanë përfituar këtë të drejtë me vendime të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.*

*12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.*

*Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## KËRKESË

### PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, TIRANË

Data e paraqitjes së kërkesës: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2010

**Subjekti përfitues:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Emri  
Mbiemri

Atësia

**Përfaqësuesi me prokurë i subjektit përfitues, që paraqet kërkesën:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Emri  
Mbiemri

Atësia

**Adresa e subjektit përfitues ose e përfaqësuesit të tij me prokurë:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Qarku

Qyteti

Fshati

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Lagja

Rruga

Numri i banesës

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Telefon

Celular

e-mail

Në përputhje me nenin 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.\_\_\_\_\_, datë\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, kërkoj kompensimin e pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimet informale.

Në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.\_\_\_\_\_, datë\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, mbaj numrin rendor\_\_\_\_\_.

Kërkuesi

\_\_\_\_\_

(emri,atësia,mbiemri)

Shënim: Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë të mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.